



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2752/prot.

3

Urë Vajgurore, më 14.10.2024

VENDIM

Nr. 45 Datë 14. 10.2024

“Mbi miratimin e dhënies së titullit të Lartë Vendor “Qytetar Nderi” i Bashkisë Dimal Z.Sotiraq Vasil Boro, Z.Luftar Brahim Shehu, Znj. Bukurie Osman Tafa, Z.Haxhi Diko Oshafi”.

Këshilli i Bashkisë Dimal, në mbledhjen e tij të datës 14.10.2024 mbi bazën e materialit të paraqitur nga Sektori i Arsimit Kulturës dhe Sporteve bazuar në propozimin e Organizatës së Veteranëve Ura Vajgurore , në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Neni 25, Neni 54, Neni 55, Ligjit 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore”, neni 15, neni 16, neni 18.

VENDOSI :

Me 13 vota PRO, nga 13 Këshilltarë prezentë :

1. Të miratojë dhënien e titullit të Lartë Vendor “Qytetar Nderi” i Bashkisë Dimal Z. Sotiraq Vasil Boro (pas vdekjes) me motivacionin:
“Për kontributin e dhënë në fushën e mësimdhënies e metodave shkencore pedagogjike. Për vlerat e larta morale dhe aftësitë e veçanta që manifestoi gjatë viteve të punës në marrëdhënie me nxënësit, mësuesit dhe prindërit”.
2. Të miratojë dhënien e titullit të Lartë Vendor “Qytetar Nderi” i Bashkisë Dimal z. Luftar Brahim Shehu” (pas vdekjes) me motivacionin:
“Për kontributin e dhënë në fushën e mësimdhënies e metodave shkencore pedagogjike. Për vlerat e larta morale dhe aftësitë e veçanta që manifestoi gjatë viteve të punës në marrëdhënie me nxënësit, mësuesit dhe prindërit”.

3. Të miratojë dhënien e titullit të Lartë Vendor “Qytetar Nderi” i Bashkisë Dimal znj. Bukurie Osman Tafa me motivacionin:

“Për kontributin e dhënë në fushën e mësimdhënies e metodave shkencore pedagogjike. Për vlerat e larta morale dhe aftësitë e veçanta që manifestoi gjatë viteve të punës në marrëdhënie me nxënësit, mësuesit dhe prindërit”.

4. Të miratojë dhënien e titullit të Lartë Vendor “Qytetar Nderi” i Bashkisë Dimal znj. Haxhi Diko Oshafi (pas vdekjes) me motivacionin:

“Për kontributin e dhënë si Kryetar i shoqatës së Vaditjes, duke ju ardhur në ndihmë fermerëve të zonës së Kutallisë, Poshnjes, Cukalatit, për përmirësimin e sistemit të vaditjes dhe lehtësimin e ujitjes së të mbjellave në sera dhe fusha”.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë .

6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të Ligjit 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore “, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK
AVDULLA SALILLARI**

